**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
***REPUBLIC OF ALBANIA***
**MINISTRIA E KULTURËS**
***MINISTRY OF CULTURE***

# INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE
## *NATIONAL INSTITUTE FOR REGISTRATION OF THE CULTURAL HERITAGE*

**Pronari** *(Owner)* SHTETI
**Poseduesi***(Possessor)* INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

*ID:* 0001
*ID:*

**Drejtori i IKRTK***(Director of NIRCH)*
**Tel: +355(4) 22 269 03**
***Web: www.ikrtk.gov.al***

**Vula (Seal)**

MINISTRIA E KULTURËS - REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE - TIRANË

## *CERTEFIKATË OBJEKTI*

**NUMËR** ***(NUMBER):*** 72500

**VENDNDODHJA** ***(LOCATION):***

**Shteti** *(State)*: Shqipëri **Qarku** *(Region)*: Qark **Rrethi** *(District)*: Qytet

**Qytet/Fshat***(City/Country)*: Sarande **Rruga** *(Street)*: -

**FUSHA** ***(DOMAIN):*** ARKITEKTURE

**KATEGORIA** ***(CATEGORY):*** Objekte Kulti

**TIPI** ***(TYPE):*** Bazilike

**TITULLI** ***(TITLE):*** Kisha "Shën e Premtes, Lukovë" Sarandë

**MATERIALI** ***(MATERIAL):*** Gur

**FOTOGRAFIA E OBJEKTIT 6 me 9 (cm)**
*(PHOTOGRAPHY OF OBJECT 6 by 9 cm)*



**Nr. i Regjistrit** ***(No. of Register):***
**Nr. i Inventarit** ***(No. of Inventory):***

**KATALOGU (CATALOGUE)**

""

**SHITBLERJET***(SALES AND BUYES):*

**ADRESA E PRONARIT DHE FIRMA**
*(ADDRESS OF OWENER AND SIGNATURE):*

**ADRESA E POSEDUESIT DHE FIRMA**
*(ADDRESS OF POSSESSOR AND SIGNATURE):*

**PRONARI I RI** *(NEW OWNER):*

**SKEDUESI** *(COMPILER):* FERDINANT YZEIRI

**DATA***(DATE):* 10/06/2015

**KOMISIONI I VLERËSIMIT** *(COMMISSION OF ASSESSMENT):*

**1.**
**2.**
**3.**

**DREJTOR**
**(DIRECTOR)**

***Në bazë të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", objekti klasifikohet pasuri kulturore.***

***According to Law 27/2018 "On Cultural Heritage and Museums", the object is cultural property.***

**TË DHËNAT KRYESORE TË OBJEKTIT**
**MAJOR DATA OF THE OBJECT.**

**TEKNIKA** *(TECHNIQUE):* E perzier

**KULTURA** *(CULTURE):* Shqiptare Mesjetar

**PERIUDHA** *(PERIOD):* Mesjetë e Vonë (-)

**AUTORI** *(AUTHOR):* ANONIM ANONIM

**PËRMASAT***(DIMENSIONS):*

**Gjatësia** *(Length):* 12.6 **Gjërësia** *(Width):* 6.3 **Lartësia** *(Height):* -
**Njësia** *(Unit):* METER

**PESHA** *(WEIGHT):*

**VLERA** *(VALUE):*

**DORËZUESI** *(DELIVERER):*

**PËRSHKRIMI** *(DESCRIPTION):*

Kisha "Shen e Premte" ndodhet ne Lukovë - Sarandë. Ështe një kishë e tipit bazilikal me kupolë trefishe, me përmasa të brendshme 12.6 x 6.3m. Kollonat që ndajnë nefet janë të lidhura ndërmjet tyre dhe me muret veriore e jugore, me harqe ne drejtimin terthor.

Në nefin qëndror harqet krijojnë brinjë qendrueshmërie për qemerin cilindrik që mbulon atë, ndërsa në nefet anësore, harqet kufizojnë bërthama të mbuluara me qemere cilindrike, të cilat hapen ndaj nefit qendror. Hapësira e dytë nga lindja, mbulohet me kupolë, e cila ngrihet mbi një tambur të lartë. Ambjenti i altarit zgjeron hapësiren e tij nëpërmjet daljes jashtë të apsides së bemës. Kisha ka hyrje nga ana jugore dhe ajo perëndimore, drejtpërdrejt nga jashtë. Kishes I mungojnë narteksi dhe hajati, tipar ky i takuar edhe në kishat e tjera te bregdetit. Interieri ndriçohet dobët nga dritare të ngushta në formë frëngjie, të hapura në muret jugore, perëndimore dhe në tambur. Kisha është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, të vendosura në radhë të rregullta ne muraturë. Fugaturat janë të rrafshuara mirë me llas, gjë që krijon sipërfaqe të pastra të muraturës. Muratura përfundon me një kornizë të thjeshtë prej guri. Në ndryshim nga pjesa tjetër, apsida eshte e përpunuar me nike të harkuara nga sipër, duke i dhënë muraturës së saj më tepër reliev. Catia eshte dyujëse dhe ndërpritet vetëm në pjesën qëndrore nga volumi tetëfaqësh I tamburit. Në mungesë të të dhënave epigrafike, duke bërë paralelizma me kishat e tjera të bregdetit, mendohet se kisha e Lukovës duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek XVII.

Objekti paraqitet në gjendje të rënduar dhe me një nevojë të menjëhershme për ndërhyrje për sigurimin e qëndrueshmërise statike. Kryesisht ky objekt kërcenohet nga ndërthurja gati organike e strukturës me vegjetacionin. Rrënjet dhe degë të pemëve kanë depërtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrueshmerinë e objektit, duke e ngarkuar dhe duke krijuar varësi të pashmangshme. Në momente te veçanta ka çarje të tilla që arrijne deri ne 20 cm.

**TË DHËNA TË TJERA** *(OTHER DATA):*

MINISTRIA E KULTURËS - URDHËR Nr.8 dt.08.01.2015 "PËR RISHPALLJE MONUMENT KULTURE TË KATEGORISË SË I-& TË OBJEKTIT "KISHA E SHËN E PREMTES", LUKOVË, SARANDË DHE PËRCAKTIMIN E ZONËS SË MBROJTUR RRETH TIJ"

**RESTAURIMI:** Çdo lloj ndërhyrje; kush e ka bërë, si dhe rilevimi topologjik i objekteve të paluajtshme.

**(*RESTORATION*):** *Any kind of restoration work; the person(s) that have carried it out, as well as the topographic survey of immovable objects.*

**SHKALLA E DËMTIMIT** *(SCALE OF DAMAGE):* 3

1. Shumë Mirë; ... 10. Shumë Keq *(1. Very Good; ... 10. Very Bad)*

**ORIGJINALE/KOPJE** *(ORIGINAL/COPY):* Orgjinale

**VEND ORIGJINA** *(ORIGIN PLACE):*

**VENDI I RUAJTJES** *(STORAGE LOCATION):*

**TRASHËGIMI** *(HERITAGE):* **Po**

**HISTORIKU:** Ku dhe kur është zbuluar; kur ka marrë statusin e trashëgimisë kulturore.

*(HISTORIC INFORMATION)*: *Place and date of discovery, date of gaining the status of cultural heritage.*

MINISTRIA E KULTURËS - URDHËR Nr.8 dt.08.01.2015 "PËR RISHPALLJE MONUMENT KULTURE TË KATEGORISË SË I-& TË OBJEKTIT "KISHA E SHËN E PREMTES", LUKOVË, SARANDË DHE PËRCAKTIMIN E ZONËS SË MBROJTUR RRETH TIJ"
Në vijim të kërkesës nr.389 prot, datë 31.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve konstatova se në mbledhjen e datës 24.12.2014 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve me Vendimin nr.143, datë 24.12.2014, ka shqyrtuar dokumentacionin mbi propozimet e diskutuara ne Këshillin Shkencor për shpallje Monument Kulture.
Nisur sa më sipër, në mbeshtetje të nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe pika 4 e nenit 28 dhe nenit 32 të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgimine Kulturore" i ndryshuar.
1. Rishpalljen Monument Kulture kategoria I-rë të objektit "Kisha e Shën e Premtes", Lukovë, Sarandë, sipas hartës bashkëlidhur.
2. Miratimi i zonës së mbrojtur të objektit "Kisha e Shën e Premtes", Lukovë, Sarandë, sipas hartëa bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" për njoftimin e këtij urdhri.
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjeherë.
MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI

**LËVIZJET E OBJEKTIT** *(MOVEMENTS OF OBJECT):*

**BIBLIOGRAFIA** *(BIBLIOGRAPHY):*